



## INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

---

**Datë: 21.04.2026**

Në bazë të neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit për Veprimtari Kërkimore Shkencore nr: 04/L-135 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 12, 13 dhe 16 të Statutit të Institutit Albanologjik të datës 27.04.2015, nenit 8 të Ligjit të Punës, nr 03/L-212, Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punonjësve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Albanologjik dhe vendimit të Këshillit Shkencor të Institutit të datës 01.04.2026, Institutit Albanologjik - Prishtinë, shpall:

### KONKURS

#### ZGJEDHJE, RIZGJEDHJE-AVANCIM TË PUNONJËSVE SHKENCORË

##### I. DEGA E HISTORISË

- Një këshilltar shkencor (rizgjedhje-avancim)
- Një bashkëpunëtor i lartë shkencor (rizgjedhje-avancim)

##### II. DEGA E GJUHËSISË

- Një bashkëpunëtor i lartë shkencor (rizgjedhje-avancim)

#### PËRSHKRIMI I PUNËVE:

**1. Këshilltari shkencor** – merr pjesë në përgatitjen e planeve dhe programeve të punës kërkimore–shkencore; studion problemet që kërkojnë njohuri të gjithanshme teorike dhe metodologjike nga disiplina shkencore e tij apo disiplinat e afërta; punon lidhur me pjesët më të rëndësishme të programit, u jep këshilla e udhëzime bashkëpunëtorëve në Degë, përcjell rezultatet më të reja nga fusha apo specializimi i tij më i ngushtë; punon rreth temave që shkruhen (përgatit trajtesa, studime, monografi nga dega e tij; përgatit referate apo kumtesa për sesionet shkencore); studion materialet e mbledhura në Institut; dokumentet, periodikët, shtypin dhe literaturën e nevojshme në vend dhe në botën e jashtme; bën hulumtime në terren, individualisht apo në ekspedita në vend apo jashtë; punon rreth perfeksionimit shkencor në disiplinën përkatëse, përcjell literaturën shkencore dhe konsultohet me bashkëpunëtorët e rinj; punon rreth blejve (bën redaktimin kritik shkencor dhe shkruan parathëniet e blejve); trajton probleme metodologjike që kanë rëndësi të përgjithshme për realizimin e detyrave kërkimore, trajton në mënyrë teorike problemet e ndryshme me rëndësi të veçantë; udhëheq dhe koordinon punët e grupeve të ndryshme kërkimore –shkencore; vlerëson karakterin shkencor të projekteve të programeve të ndryshme; bën recensionet e punëve të kryera kërkimore në kuadër të Institutit; u ndihmon bashkëpunëtorëve të rinj në aftësimin e tyre në punën kërkimore-shkencore.

**KUSHTET:** Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të përcaktuara me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr.04/L-135, Statutin e Institutit, si dhe me Rregulloren për Procedurat

e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punonjësve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Albanologjik, për vlerësimin e punës kërkimore shkencore:

- Të këtë gradën e doktorit të shkencave i fushës përkatëse;
- Të këtë titullin kërkimor shkencor paraparak bashkëpunëtor i lartë shkencor (profesor i asocuar);
- Të këtë të botuara së paku tri (3) vepra shkencore autoriale nga institucionet shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit;
- Të këtë së paku pesë (5) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante kombëtare dhe ndërkombëtare nga periudha përkatëse, tri (3) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
- Të këtë pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, pas zgjedhjes së fundit, së paku pesë (5) konferenca, nga te cilat dy (2) ndërkombëtare;
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

**2. Bashkëpunëtori i lartë shkencor:** merr pjesë në përgatitjen e programeve të punës kërkimore shkencore; studion problemet që kërkojnë përgatitje të mirë teorike dhe metodologjike nga disiplinat e caktuara; merr pjesë në përgatitjen metodologjike për punë të ndryshme kërkimore shkencore për realizimin e projekteve të caktuara kërkimore; studion problemet e ndryshme nga lëmi shkencor i tij; bën hulumtime në mënyrë të pavarur lidhur me temën; përpunon pjesët e vështira dhe të rëndësishme të programit; punon në mënyrë të pavarur rreth temave që shkruhen dhe rreth përgatitjes së blejve shkencorë; kryen recensionin e punimeve të ndryshme të bashkëpunëtorëve të tjerë dhe ndihmon bashkëpunëtorët më të rinj në aftësimin e tyre për punë shkencore.

**KUSHTET:** Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e veçanta të përcaktuara me Ligjin për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nr.04/L-135, Statutin e Institutit, si dhe me Rregulloren për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punonjësve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin Albanologjik, për vlerësimin e punës kërkimore shkencore:

- Të këtë gradën shkencore doktor i shkencave i fushës përkatëse;
- Të këtë titullin kërkimor shkencor paraparak bashkëpunëtor shkencor ( profesor asistent);
- Të këtë të botuara së paku dy (2) vepra shkencore autoriale nga institucionet shkencore, një prej të cilave pas zgjedhjes së fundit;
- Të këtë së paku tri (3) punime shkencore të publikuara në revista shkencore relevante kombëtare dhe ndërkombëtare nga fusha përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit;
- Të këtë pjesëmarrje në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare, së paku tri (3) konferenca, nga të cilat një (1) ndërkombëtare;
- Përvojë në projekte shkencore, të cilat janë të udhëhequra nga institucionet shkencore, akademike, universitare;
- Aftësi për udhëheqje të projekteve kërkimore-shkencore dhe akademike.

### **Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:**

1. Kandidatët që konkurrojnë për zgjedhje, rizgjedhje ose avancim në titullin: **këshilltar shkencor** duhet të dorëzojnë:

- Biografinë edhe bibliografinë (me kopjet e punimeve të botuara), sidomos të atyre pas zgjedhjes së fundit;

- Diplomën origjinale ose të noterizuar të gradës shkencore doktor i shkencave nga fusha përkatëse (për kandidatët që konkurrojnë për titullin këshilltar shkencor)
- Nëse kandidati ka mbrojtur doktoratën jashtë vendit, diploma të jetë e nostrifikuar nga MASH-i;
- Dëshminë nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime;
- Certifikatën mbi njohjen e gjuhës së huaj, të lëshuar nga institucioni i akredituar për gjuhë të huaja (për kandidatët që konkurrojnë për herë të parë).

2. Kandidatët që konkurrojnë për zgjedhje, rizgjedhje ose avancim në titullin: **bashkëpunëtor i lartë shkencor**, duhet të dorëzojnë:

- Biografinë edhe bibliografinë (me kopjet e punimeve të botuara), sidomos të atyre pas zgjedhjes së fundit;
- Diplomën origjinale ose të noterizuar të gradës shkencore doktor i shkencave nga fusha përkatëse;
- Nëse kandidati ka mbrojtur doktoratën jashtë vendit, diploma të jetë e nostrifikuar nga MASH-i;
- Dëshminë nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime;
- Certifikatën mbi njohjen e gjuhës së huaj, të lëshuar nga institucioni i akredituar për gjuhë të huaja (për kandidatët që konkurrojnë për herë të parë).

**Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit të tij në faqen zyrtare të Institutit në internet, përkatësisht deri më 05.05.2026.**

Kërkesat me dokumentacionin përkatës dorëzohen drejtpërdrejt në Institut ose nëpërmjet postës në adresën: Instituti Albanologjik i Prishtinës. Rr. “Eqrem Çabej”, nr: 93, Prishtinë. Kërkesat e kandidatëve që nuk i plotësojnë kushtet sipas konkursit, nuk do të merren në shqyrtim.